



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
TIRANA AGRIKULTURË SH.P.K

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Tiranë, 02.05.2023

Drejtuar: “Pastrime Silvio” sh.p.k. me NIPT K91413010N

Adresa: Rruga "Fatmir Haxhiu", Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I, Tiranë

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Shërbime

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-64531-03-31-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Shërbime të pastrimit, dezinfektimit dhe gjelbërimit për nevoja të “TIRANA AGRIKULTURË” sh.p.k”**.

Kohëzgjatja e kontratës: 8 (tetë) muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Fondi limit: 4,611,481 (katër milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “Pastrime Silvio” sh.p.k. me NIPT K91413010N, me vlerë 3,107,755 (tre milion e njëqind e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.
2. BOE “ATLANTIK 3” sh.p.k. me NIPT K22218003V, “Egian Med” sh.p.k. me NIPT L71715003C & “ONYX” sh.p.k. me NIPT L62130005H, me vlerë 4,315,940 (katër milion e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzetë) lekë pa TVSH.
3. “REJ” sh.p.k. me NIPT J93711608Q, me vlerë 3,936,955.40 (tre milion e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë pikë dyzet) lekë pa TVSH.
4. “CLEAN FAST” sh.p.k. me NIPT L61807037R me vlerë 4,195,000 (katër milion e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.
5. “SILVER” sh.p.k. me NIPT K88010301S me vlerë 4,424,330 (katër milion e katërqind enjëzetë e katër mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE "ATLANTIK 3" sh.p.k. me NIPT K22218003V, "Egian Med" sh.p.k. me NIPT L71715003C & "ONYX" sh.p.k. me NIPT L62130005H, nuk përmbush kriteret e mëposhtme:

- Nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të ketë në stafin e tij një drejtues Teknik me profil Inxhinier Mjedisi / Menaxhim Mjedisi. Nga verifikimi i dokumentacionit nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave vëmë re se operatori ekonomik në deklaratën e bërë ka paraqitur drejtues Teknik me profil Inxhinieri Agrare dhe jo Ing. Mjedisi / Menaxhim Mjedisi.

2. "REJ" sh.p.k. me NIPT J93711608Q, nuk përmbush kriteret e mëposhtme:

- Nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë deklaratën e punonjësve. Nga verifikimi i dokumentacionit nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave vëmë re se operatori ekonomik e ka paraqitur deklaratën jo në formën e duhur ligjore, të pa firmosur e të pa vulosur.

- Operatori nuk ka në fushën e veprimtarisë në QKB tërësisht objektin e prokurimit, pasi ka pastrimin dhe dezinfektimin e kazanëve, dhe jo gjelbërimin dhe dezinfektimin e ambienteve.

- Në shtojcën 1-2 Opeatori ekonomik nuk e ka paraqitur ofertën duke studiuar me vëmendje specifikimet teknike/termat e referencës. Pra, deklaroi se i përmbush specifikimet, por në të vërtetë nuk i ka lexuar me kujdes. Oferta është paraqitur pa llogaritur frekuencën e kryerjes së shërbimit, një element thelbësor që ndikon në çmimin e ofertës.

3. "CLEAN FAST" sh.p.k. me NIPT L61807037R, nuk përmbush kriteret e mëposhtme:

- Nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të bëjë plotësimin e shtojcës 9 *Formulari vetëpërmbledhës i deklaramit*. Por nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se operatori në shtojcën 9 të Formularit vetëpërmbledhës të deklaramit, nuk ka deklaruar:

- a) personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikqyrësit, si aksionar ose si ortak...;
- b) Targën e mjetit të kërkuar, mbi disponimin e makinerive të nevojshme.

- Në shtojcën 1-2 Opeatori ekonomik nuk e ka paraqitur ofertën duke studiuar me vëmendje specifikimet teknike/termat e referencës. Pra, deklaroi se i përmbush specifikimet, por në të vërtetë nuk i ka lexuar me kujdes. Oferta është paraqitur pa llogaritur frekuencën e kryerjes së shërbimit, një element thelbësor që ndikon në çmimin e ofertës.

4. "SILVER" sh.p.k. me NIPT K88010301S, nuk përmbush kriteret e mëposhtme:

- Nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit është kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë licencën e QKL (të vlefshme) me kod II.8.B për kryerjen e veprimtarisë “Shërbime ndërhyrëse higjeno-shëndetësore si dezinfektim, deratizim, dezinfektim”. Nga verifikimi i dokumentacionit nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave vëmë re se operatori ekonomik nuk e ka paraqitur licencën e sipërpërmendur.
- Në shtojcën 1-2, oferta është paraqitur duke llogaritur frekuencën e kryerjes së shërbimit, por në listën e çmimeve, tek kolona çmimi për njësi, është vendosur në mënyrë të gabuar çmimi për sasi.

* * *

Duke ju referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “Pastrime Silvio” sh.p.k., se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 3,107,755 (tre milion e njëqind e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë shoqërisë “Tirana Agrikulturë” sh.p.k., sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Ermal ELEZI